



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 30.08.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **25.08.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **AGS Corporation Sh.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së”** LOT 7, me numër prokurimi **206-23-4215-1-1-1**, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e operatorit ekonomik AGS Corporation Sh.P.K., e dt.25.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së” Lot 7, me numër prokurimi 206-23-4215-1-1-1, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 21.08.2023, të publikuar në platformën elektronike;
2. **Mbeten në fuqi** Njoftimi mbi Vendimin e AK, i datës 21.08.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon tutje me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori ekonomik AGS Corporation Sh.P.K., me datë 25.08.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së” – Lot 7, me numër prokurimi 206-23-4215-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE AGS Corporation Sh.P.K.:

- Neni 7— Barazia në Vlerësim/ Jo — diskriminimi
- Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës
- Neni 28 — Rregullat për specifikime teknike
- Neni 59 — Vlerësimi/ Krahasimi i tendereve
- Neni 60 -- Kriteret për dhenie të kontratës
- Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

KREU IV - UDHEHEQJA E PROCEDURAVE TE PROKURIMIT

Neni 59 — Paragrafi 2 dhe 4 dhe Neni 60, pika 1.1

Paragrafi 2 i nenit 59 te LPP thot se: Autoriteti kontraktues mundet qe me shkrim te kërkojë nga një tenderues qe te sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, ne mënyrë qe te behet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tendereve, Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet te kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose te ofrohen nga një tenderues.

PJESA II

KREU I - RREGULLAT PER SPECIFIKIMETTEKNIKE DHE DOSJEN E TENDERIT

Neni 28 - Paragrafi 6, 7, 8 dhe 9

Paragrafi 6 i ketij neni te LPP thot se: Nese një tenderues mund ta paraqet ne tenderin e tij, permes çfarëdo mase te duhur (siç jane, dosjet teknike ose raport testimi nga nje pale e trete e pavarur)/ se zgjidhja e propozuar nga tenderuesi ne menyre ekuivalente ploteson kerkesat e definuara ne specifikim teknik, autoriteti kontraktues nuk mund ta refuzoj tenderin me arsyetimin se produkti ose sherbimi i ofruar nuk perputhet me specifikimet teknike te formuluar duke iu referuar ndonje specifikimi te permendur ne paragrafin 4. dhe 5. Te ketij neni,

Paragrafi 9 i ketij neni te LPP thot se :Kur autoriteti kontraktues e ka parashtruar specifikimin teknik por kerkesat ekzekutuese ose funksionale, ai nuk mund të perdore kerkesat e tilla si arsyetim per refuzimin e tenderit, produktit ose sherbimit qe eshte ne perputhshmeri me nje specifikim te permendur ne paragrafin 4. dhe 5. te ketij neni nese specifikimi i tille trajton kerkesat e njejta ekzekutuese ose funksionale dhe eshte i pershtatshem. Tenderuesi duhet te paraqese ne tenderin e tij, ne menyren me te pershtatshme (siç eshte ajo e dosjeve teknike ose raportit te testimi nga nje pale e trete e pavarur) qe produkti ose sherbimi, jane ne perputhshmeri me specifikimet e lartpermendura gjithashtu i ploteson kerkesat ekzekutuese ose funksionale te autoritetit kontraktues.

KREU IV - UDHEHEQJA E PROCEDURAVE TE PROKURIMIT

Neni 59 — Paragrafi 2 dhe 4 dhe Neni 60, pika 1.1

Paragrafi 2 i nenit 59 te LPP thot se: Autoriteti kontraktues mundet qe me shkrim te kerkoje nga nje tenderues qe te siguroje nje sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, ne menyre qe te behet ekzaminimi, vleresimi ose krahasimi i tendereve. Asnjë ndryshim material dhe asnje aspekt i tenderit nuk duhet te kerkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose te ofrohen nga një tenderues.

Paragrafi 4 i nenit 59 te LPP thot se: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund te korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tendereve.

KREU III KËRKESAT E PËRGJITHËSHME

Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon te ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur. Për qëllime të paragrafit 3. të këtij neni, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (i) në datën e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, (ii) në datën e dhënies së kontratës në rast të tendereve sipas nenit 37 të këtij ligji, ose (iii) nëse aktiviteti i prokurimit formalisht është anuluar ose përndryshe është përfunduar para dhënies ose zgjedhjes së fituesit, atëherë në datën e njoftimit për anulim sipas paragrafit 2. te nenit 62 të këtij ligji ose në datën kur aktivitetet ishin përmbyllur.

Neni 72

Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar/ Ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.
2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.
3. Sigurimi i informacionit që mungon Ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistencë e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Pretendimet ankimore:

LOTI 7

PERIMETËR I AUTOMATIZUAR - UPS, TABELË E MOTORIZUAR, BATERI rimbushëse - UPS, KARRIGE PËR EKZAMINUES DHE PACIENT

Ne njoftimin për vendimin e autoritetit kontraktues, jemi njoftuar që jemi eliminuar nga LOT7 për arsye që komisioni nuk i ka evidentuar disa finesa teknike nga specifikimi teknik, pra duke qenë se jemi reth

9.000 EUR me lire se OE I propozuar për Kontrate (Ku komisioni I AK me ose pa dashje demton buxhetin e shtetit), mendojme që është shkelur neni 72 i LPP sepse nuk na janë kërkuar fare sqarime shtese që parashihen në këtë nen.
Rijedhimisht finesat për të cilat komisioni I supozon që nuk përputhen që të gjitha mund të gjenden dhe në publikimet shkencore të prodhuesit European OPTOPOL të cilat janë dhe të qasshme online e me se miri do të ishin afruar tek Komisioni sikur të respektohej neni 72 i LPP dhe të na kerkoheshin sqarime shtese që i obligon LPP.

Me kerkese zyrtare na është mundësuar qasja në dokumentet e fituesit të këtij LOT7 e që vlen të ceket që qasja ka qenë profesionale dhe na është ofruar cdo material që kemi kërkuar e që na mundësohet me LPP.

Gjate vlerësimit të dokumentacionit zyrtarisht të marrur nga AK, vorejme se Komisioni ka bërë shkelje flagrante gjate vlersimit, ku ka propozuar për kontrate OE e cili nuk e ofron gati gjysmen e pajisjes e kërkuar sipas specifikacionit teknik, pra komisioni propozon për kontrate OE I cili NUK ESHTË I PERGJEGJSHËM.

Te gjeturat teknike gjate qasjes në dokumentet zyrtare të OE të propozuar për Kontrate :

PIKAL.

OE I propozuar për kontrate ka ofertuar me pajisjen Haag Streit OCTOPUS 900 Pro, por nuk ka ofertuar për aksesoren si më poshte :

LOTI 7

PERIMETËR I AUTOMATIZUAR - UPS, TABELË E MOTORIZUAR, Bateri rimbushëse - UPS, KARRIGE PËR EKZAMINUES DHE PACIENT

1. Tavolinë e motorizuar, lartësia e rregullueshme e së njëjtës markë me rrota vogla të rrotullueshme me frena, këllëf paketimi (1), përshtatës elektrik (1) - 1 set

OE nuk e ka deshmuar ofertimin e këtij aksesori (tavoline) si kerkese teknike e detyrueshme dhe si I tille OE eshte I papergjegjshem.

PIKA2.

OE I propozuar per kontrate ka ofertuar me pajisjen Haag Streit OCTOPUS 900, por nuk ka ofertuar per aksesoren si me poshte :

LOTI 7

PERIMETËR I AUTOMATIZUAR - UPS, TABELË E MOTORIZUAR, Bateri rimbushëse - UPS, KARRIGE PËR EKZAMINUES DHE PACIENT

2. Karrige rrotulluese - 1 copë

OE nuk e ka deshmuar ofertimin e këtij aksesori (karrike) si kerkese teknike e detyrueshme dhe si I tille OE eshte I papergjegjshem.

PIKA3.

OE I propozuar per kontrate ka ofertuar me pajisjen Haag Streit OCTOPUS 900, por nuk ka ofertuar per aksesoren si me poshte :

LOTI 7

PERIMETËR I AUTOMATIZUAR - UPS, TABELË E MOTORIZUAR, Bateri rimbushëse - UPS, KARRIGE PËR EKZAMINUES DHE PACIENT

3. Karrige e pacientit me rregullim të lartësisë - 1 copë.

OE nuk e ka deshmuar ofertimin e këtij aksesori (karrike) si kerkese teknike e detyrueshme dhe si I tille OE eshte I papergjegjshem.

PIKA4.

OE I propozuar per kontrate ka ofertuar me pajisjen Haag Streit OCTOPUS 900 , por nuk ka ofertuar per aksesoren si me poshte :

LOTI 7

PERIMETËR I AUTOMATIZUAR - UPS, TABELË E MOTORIZUAR, Bateri rimbushëse - UPS, KARRIGE PËR EKZAMINUES DHE PACIENT

4. E pajisur me bateri të rikarikueshme - UPS: autonomi ≥ 30

OE nuk e ka deshmuar ofertimin e këtij aksesori (UPS AUTONOMI ≥ 30) si kerkese teknike e detyrueshme dhe si I tille OE eshte I papergjegjshem.

PIKA5.

OE I propozuar per kontrate ka ofertuar me pajisjen Haag Streit OCTOPUS 900 , por nuk ka ofertuar per piken si me poshte :

LOTI 7

**PERIMETËR I AUTOMATIZUAR - UPS, TABELË E MOTORIZUAR, BATERI
rimbushëse - UPS, KARRIGE PËR EKZAMINUES DHE PACIENT**

PAJISJA DHE SOFTUERI

1. Softuer me përditësime të pakufizuara dhe antivirus me përditësime të pakufizuara.

OE nuk e ka deshmuar ofertimin e antivirusit apo te ndonje forme tjeter te sigurise softuerike pasi qe dhe oferta nuk permban kompjuter I cili domosdoshemerisht jep qasje ne siguri softuerike pra kjo kekesa teknike e detyrshme nuk eshte permbush dhe si I tille OE eshte I papergjegjshem.

PIKA6.

OE I propozuar per kontrate ka ofertuar me pajisjen Haag Streit OCTOPUS 900, por nuk ka nenvizuar katalogun siq kerkohej ne FDT e qe ilustrohet me poshte:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

Kërkesa 2. Operatori ekonomik te prezantoj katalogun (broshurën) e pajisjeve te ofruara dhe te nenvizohen ne menyre te qarte produktet dhe specifikat teknike te ofruara. Nëse ofrohet broshura, duhet te specifikohet linku i veb faqes.

Prandaj kerkojme nga AK qe te zbatoj ligjin dhe kete lende ta kthej ne Rivlersim, te respektohen dispozitat ligjore dhe te ruhet buxheti i shtetit, ne te kunderten jemi te detyruar qe te drejten ta kerkojme ne instancat me te larta.

Demet materiale

Demet perفشijne kostot e pergatitjes se tenderit, sigurimi, koha e punes se stafit, prishjen apo rrezikimin e raporteve biznesore/afariste me prodhuesin e njohur Optopol ne Europa, demtimin e reputacionit te kompanise dhe mohimi I te drejtes per fitime komerciale nga ana e AK.

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore te OE ankues:

I konsiderojmë te pa bazuara pretendimet tuaja ankimore ne lidhje me ofertën tuaj per Lot 7, duke marre parasysh se gjate vlerësimit te aktivitetit, komisioni i ka verifikuar produktet e ofruara nga ana juaj dhe i ka potencuar mangësitë ne specifika. Produkti i ofruar nga ana juaj nuk i ka plotesuar specifikat teknike te kerkuara sipas DT-se, ju lutem refrohuni Njoftimit mbi vendimin e AK-se te dates 21.08.2023, ku jane specifikuar mangesite si me poshte:

Mungojnë specifikat teknike në katalogun e ofertuar:

1. *Stimulus generation: Mirror projection system*
2. *Background illumination (asb): 0/4/31/314 (0 dhe 4 mungojne)*
3. *Stimulus duration (ms): 100, 200, 500, 1000, infinite (mungon infinite)*
4. *Mungojnë:*

- a. No, (Dynamic (adaptive step size, 6-8 min),
 - b. No, (Normal (4-2-1 bracketing, 10-12 min),
 - c. No, (LV: Low Vision with Goldmann size V;
 - d. No, (2-LT: 2-Level Test),
 - e. No, (1-LT: 1-Level Test);
5. No, (D1: Diabetes)
 6. Progression analysis:
 - a. Global progression (MD, sLV) (ben te tjera analiza)
 - b. Cluster Trend/Polar Trend (ben te tjera analiza)

I konsiderojmë të pa bazuara pretendimet tuaja ankimore në lidhje me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, duke marrë parasysh se përveq katalogut për pajisjet e kerkuarsa, në ofertën e tij ka prezantuar edhe deklaratën me të cilën ka siguruar AK se për të gjitha lotet e ofertuara përfshihen edhe aksesoret, të cilët do të liferohen së bashku me pajisjen, shih deklaratën në vijim:

Deklaratë

Titulli: "Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së"

Nr1 I prokurimit

206-23-4215-1-1-1

Ne Meditech sh.p.k deklarojmë se për të gjitha llojet që kemi bërë ofertë , në ofertë janë të përfshira : Motorized table charis, Rechargeable batteries UPS, Charis for Examiner and Patient , për secilin lloj sic janë kërkuar në dosjën e tenderit. Gjithashtu në ofertë përfshihen edhe ALL in ONE PC me performanca kompatible sic i kërkon prodhuesi i paisjës , për llojet ku është kërkuar PC.



A handwritten signature in black ink, appearing to be "A. Q."

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Vendimi i dorëzohet:

1. AGS Corporation Sh.P.K.
2. Operatoreve ekonomik te interesuar


Berat Marmullaku

Zyrtar përgjegjës i Prokurimit